VENDIM
Nr. 88, datë 29.6.2012

PËR MIRATIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2012

Në mbështetje të neneve 9 dhe 12 pikat 1 dhe 3 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.6.2012 pasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Administrim Financës dhe Marrëdhënieve me Jashtë, mbi përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2012, për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike dhe konsideroi të drejtë llogaritjen e pagesave të rregullimit, sipas peshës specifike që zënë të ardhurat e secilit operator ndaj totalit të të ardhurave të sistemit,

VENDOSI:

1. Përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2012 për të licencuarit në sektorin energjisë elektrike sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani